



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI.

Sesioni Pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 20.

Prishtinë, më 11.05.2018 në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu- Kodra, Armend Zemaj, Fikrim Damka, Fitore Pacolli, Fatmire Kollçaku, Ilir Deda, Zenun Pajaziti, dhe Milaim Zeka.

Munguan: Glauk Konjufca dhe Adem Hoxha.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Pjesëmarrësit e tjerë: Përfaqësuesi nga GIZ, OSBE-së, NDI, KDI, Zyra e BE-së dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi Blerta Deliu- Kodra, kryetare e komisionit

Kryetarja, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen e komisionit me këtë;

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.04.2018;
3. Raportim i z. Shyqiri Bytyçi, ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për zbatimin e Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit (PKZMSA) dhe Agjendës për Reforma Evropiane (ERA);
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.04.2018

Procesverbali, i mbledhjes së datës 19.04.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Raportim i z. Shyqiri Bytyçi, ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për zbatimin e Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) dhe Agjendës për Reforma Evropiane (ERA)

Kryetarja i uroj mirëseardhje ministrit dhe falënderoj që i është përgjigjur ftesës për të diskutuar për zbatimin e PKZMSA-së dhe ERA-në. Ajo i tha se në muajin e kaluar e kemi marrë Raportin për vendin të cilin e kemi shqyrtuar në seancë. Në raport shihet se është cilësuar një progres tepër i ultë në ministrin tuaj dhe se rekomandimet e mëhershme të dhëna nga Komisioni Evropian nuk janë adresuar sa i përket çështjeve arsimore. I përmendet 15 zotime, 4 prej të cilave 4 ende nuk janë zbatuar.

Si do t'i qaseni këtyre 4 zotimeve dhe a do të ketë ndonjë afat kohor ku do të kryhen. Çështjet arsimore të Republikës së Kosovës kanë qenë ndër sfidat kryesore në raportin për vendin, andaj kërkon një dimension serioz të shqyrtimit dhe të trajtimit.

Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Shyqiri Bytyçi njoftoi komisionin lidhur me zhvillimet në integrimet evropiane dhe për zotimet të cilat janë marrë për rrjedhjen e reformës evropiane dhe MSA-së nga ministria që e drejton.

Lidhur me zotimet e marra nga MSA tha se nga momenti i marrjes së detyrës kemi parë raportin për të parë se si kanë lëvizur gjërat deri në marrjen e detyrës, lidhur me obligimet që dalin nga MSA, MASHT i ka realizuar shumicën prej tyre.

Nga 15 zotimet e dala vetëm 4 nuk janë zbatuar dhe këto kanë të bëjnë kryesisht me Agjenci, të profesionet e rregulluara dhe kemi të bëjmë me zbatimin e neneve 51, 56 dhe 58 të MSA-së që lidhet me udhëzimet administrative, ku bëhet fjalë për profesionet e rregulluara dhe këto akte nënligjore nuk janë realizuar si pasojë e mos krijimit të agjencisë për profesionet e rregulluara. Arsyeja pse nuk është formuar është për shkak ndikime të mëdha buxhetore.

Në këtë vit planifikojmë ta rishikojmë dhe do të bëjmë kërkesë për buxhet shtesë për themelimin e kësaj agjencie që do t'i paraprinte akteve nënligjore për të plotësuar të gjitha zotimet që dalin nga MSA, ose të bëjmë një reformë të çështjes së rregullimeve të profesioneve të rregulluara, pra mos të kemi agjenci, por të kalohet në departament brenda Ministrisë së Arsimit, nëse se do të bimë dakord në qeveri që të kemi buxhet shtesë për agjenci.

Është me rëndësi të theksohet se ditë me parë së bashku me BE-në kemi bërë publikimin e një raporti, ku e kemi bërë rishikimin funksional të MASHT-it ku kemi shumë të gjetura dhe rekomandime, në kuadër të rekomandimeve është që mos të ketë numër të madh të agjencive që mund të ketë numër jo të madh të stafit. Recidivisht thuhet dhe është qëndrim i Qeverisë, që mos të kemi numër të madh të agjencive, që të fuzionohen, nëse dy agjenci që kanë me pak se 50 të punësuar të fuzionohen në një agjenci.

Po ashtu në kuadër të 3 neneve të lartpërmendura të MSA-së që kërkohet nxjerrja e akteve nënligjore është edhe Këshilli shtetëror për profesionet e rregulluara, por edhe

për këtë këshill mund ta kemi një akt nënligjor vetëm pas themelimit të agjencisë dhe mbetet si masë e pa realizuar.

Masë tjetër e pa realizuar është Agjencia shtetëror për provimin e profesioneve të rregulluara, nuk është draftuar akti nënligjor për këtë çështje sepse prapë kemi të bëjmë me krijimin e kësaj agjencie.

Lidhur me provimet shtetërore të profesioneve të rregulluara është hartuar akti ligjor dhe është miratuar nga ana e Parlamentit të Kosovës, por nuk ka pasuar me akt nënligjor si pasojë e kësaj agjencie. Masë tjetër që është kërkuar në nenin 118 të MSA-së është miratimi i Ligjit për arsimin e lartë.

Lidhur me këtë kemi formuar një grup punues të ri për me e rishqyrtuar këtë Ligj ku janë të përfshirë të gjithë aktorët e tjerë të arsimit dhe organizatat e tjera ndërkombëtare dhe vendore. Ligji është finalizuar si draft dhe është në fazën e procedurave të përkthimit në gjuhë zyrtare dhe besoj që në fillimin e javës së ardhshme do të jetë në diskutim publik dhe presim që deri kah fundi i muajit maj ta sjellim në Qeveri për aprovim dhe është një Ligj që është në përputhje me standardet evropiane.

Udhëzimet e tjera administrative të kërkuara nga MSA i kemi të realizuara, te nenet 3 dhe 4 i MSA-së kërkohet përkrahja e nxënësve dhe studenteve të komuniteteve dhe këtu është bërë një punë e mirë, janë ndarë 507 bursa për shkollimin e nxënësve joshqiptarë bazuar në udhëzimin administrative të nxjerrë nga Ministria e Arsimit.

Në nenet 85, 86, 87, dhe 88, ku kërkohet të kemi një riintegrim të qëndruar të personave të riatdhesuar edhe këtu është bërë një bashkëpunim i mirë me kryetarët e komunave dhe i kemi procedurat e rregulluara bazuar në udhëzimin administrative ku mirën menjëherë masat për zbatimin e kësaj çështje.

Masë tjetër e kërkuar në neni 118 të MSA-së është përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor, këtu kemi një lëvizje pozitive të përfshirja e madhe e fëmijëve, por këtu kërkohen parametra të lartë nga BE-ja dhe nuk kemi mundësi që këto t'i arrijmë brenda vitit 2020. Problem kyç është moshja, prej 0 deri 3 vjeçare, ku edhe pjesëmarrja në edukimin e hershëm është e ultë, kurse moshja prej 3 deri në 5 vjeçare ka ngritje të vazhdueshme, por akoma është e ultë me parametrat e BE-së. Problematikë ma e madhe është mungesa e infrastrukturës, sidomos në pjesët rurale, pastaj çështja e kostos ku familjet ngarkohen t'i dërgojnë fëmijët e tyre në çerdhe.

Ne kemi pasur një takim me Bankën botërore që e ka një projekt që na përkrah në këtë drejtim dhe jemi dakorduar që për moshën 0 deri në 2 të kemi një formë tjetër të qasjes së edukimit dhe shpresoj se shumë shpejt do të dalim me këtë projekt. Do ta bëjmë një lloj informimi të përgjithshëm për prindërit ku do t'i furnizojmë me dokumentacion dhe me literaturë në mënyrë që fëmija të mund të edukohet nga shtëpia, ndërsa për fëmijët 3 deri në 5 vjet. Qeveria do ta marrë përsipër edhe rregullimin e infrastrukturës dhe ndoshta të mendojë edhe për pjesën e kostos që familjet të cilat e kanë të pa mundur që t'i mbulojnë shpenzimet, qeveria ta kryej pagesën.

Fitore Pacolli falënderoi ministrin për raportin e detajuar, por kishte vërejtje se raporti kishte ardhur me vonesë dhe deputetet nuk kanë pasur kohë me e lexuar dhe me e komentuar.

Filloi me raportin e progresit dhe tha se fatkeqësisht edhe këtë vit raporti thotë se nuk ka fare progres sa i përket fushës së edukimit, sidomos në nivelin parafillor dhe fillor, përmendet se e kemi një projekt ku do të bëhet një ndarje për moshën 0 deri 2 vjet edukim në shtëpi, kurse 3 deri në 5 do ta marrë përsipër shteti, mendoj se kjo është problematike, sepse ne kemi nevojë që fëmijët t'i kyçim në çerdhe qysh në moshën e hershme, e jo t'i mbajmë në shtëpi, a ka mundësi ministria me vazhdua rrjetin e

çerdheve nëpër qytete dhe fshatra, mendoj se mundësit janë të pashtershme, por vetëm duhet t'i shfrytëzoni.

Do t'ju tregoj për një projekt i cili ka filluar në kohën kur ka nisur Lëvizja Vetëvendosje të qeveriste në komunën e Prishtinës, është projekti i çerdheve me bazë në komunitet. Ne në atë kohë nuk kemi pasur objekte dhe nuk kemi pasur buxhet t'i ndërtojmë çerdhet e reja, por ideja ka qenë që objektet ekzistuese të pa shfrytëzuara t'i shndërrojmë në çerdhe dhe kemi arritur që brenda dy viteve që arsimi të bëhet më në fund prioritet në Kosovë, ndërtoam 5 çerdhe të cilat tani janë model në Kosovë. Nuk e di a i keni vizituar, nëse jo shkoni dhe vizitoni dhe të shihni punën si bëhet, punoni me kurrikulen vendore dhe përfshini elementet e korrikulave të shteteve evropiane, ku përfshihet leximi në moshën e hershme, kjo mungon në çerdhet publike prej 9 mujore deri në 6 vjeçare, fëmija avancon shumë nëse vijon edukimin në një institucion edukimi, e jo vetëm për përkujdesje.

Pra, duhet të inkorporohen çerdhet nëpër ato shkolla ku nuk përdoren katet e para ose të dyta duke hapur hyrje shtesë, këto çerdhe mund të bëhen më tepër nëpër fshatra ku kanë klasa të lira.

Është më se e domosdoshme që prindërit të cilët nuk punojnë të kenë mundësi t'i dërgojnë fëmijët në çerdhe dhe duhet mbështetja e shtetit në këtë rast, sepse fëmijët të cilët ju punojnë prindërit janë më të avancuar se ata fëmijë të cilëve prindërit nuk ju punojnë, nuk mund të shkojnë në çerdhe dhe këtu kemi diskriminim të dyfishtë.

Në vazhdim ngriti çështjen e nevojës për përkujdesjen e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe tha, është e dhimbshme se si nuk ka kaluar në Kuvend amendamenti për ngritjen e numrit të edukatoreve për fëmijët me nevoja të veçanta, andaj pyeti se çka është ndërmarr për këta fëmijë, sepse ka shumë fëmijë nëpër shkolla që po lihen anash dhe kanë nevojë për mbështetje.

Kryetarja u ndërlidh me diskutimin e parafolësës dhe njoftoj se dje kishin pasur takim me Kryetarin e Kuvendit, pikërisht për çështjen që e përmendi deputetja, është kërkuar nga kryetari që për çështjen e edukatoreve me u bë zgjidhje, qoftë nga deputetët dhe në koordinim me qeverinë me e bërë një zgjidhje si çështje urgjente dhe tha, pajtohem se këta fëmijë duhet me pasur një trajtim më të veçantë.

Illir Deda falënderoi për Raportin që për herë të parë është dërguar me standardin e kërkuar nga komisioni, edhe pse me vonesë është dërguar. Në raport pashë se disa pjesë kyçe nuk po munden me u zbatuar, sepse po thuhet se nuk ka buxhet për to, ka buxhet por nuk po ka planifikim të mirë.

Një prej çështjeve emergjente për ministrinë tuaj është akreditimi i shkollave profesionale, nëse nuk bëhet kjo shpejt Kosova përjashtohet prej kornizës evropiane të kualifikimeve me të cilët punëtorët tanë të cilët janë jashtë me vizë pune duhet të kthehen në Kosovë dhe të tjerët, me viza pune nuk kanë me pasur të mundur me shkuar. Ndoshta ju kanë dhënë informata gjysmake, por shkollat profesionale janë të gatshme dhe ju inkurajojë që kjo të bëhet sa më shpejt që është e mundur.

Ne rishikim funksional të ministrisë që është publike në ueb-faqe e tregon se kjo ministri i ka kapacitetet më të dobëta administrative, jo për fajin tuaj, por e trashëguar, por rekomandimet që janë dalë me rishikim funksional janë obliguese që të zbatohen sepse asistenca në radhë të parë prej BE-së ndërlidhet me zbatimin e tyre. Do të ishte mirë që pas një periudhe ta informoni Komisionin se si po ec zbatimi i këtyre rekomandimeve. Në fund tha se ka gjasa që stafi civil në Agjencinë e akreditimeve dhe autoritetit për kualifikime kombëtare të largohet, këtu ka kuadro të përgatitura mirë që vështirë mund të zëvendësohen.

Armend Zemaj tha se neve, si komision, nga perspektiva e Komisionit për Integritet Evropian dhe në bazë të mandatit, na intereson zbatimi i agjendës së reformës evropiane dhe sidomos zbatimi i MSA-së në plotësi, për me u lehtësuar rruga drejt integritetit evropian. Është obligim i juaj që të insistoni që mos të ketë stagnim, që po shihet edhe nga raporti që nga të gjitha ato masa, Qeveria nga viti i kaluar në masë minimale ka arritur t'i zbatojë në vitin 2017.

Kjo tregon logjikën se si funksionon Qeveria, ne insistojmë që ju ta kryeni punën tuaj dhe mos të kemi më raporte, siç e kemi shijet, ku arsimin e paraqet në nivelin më të ultë. Mua personalisht me intereson arsimi i lartë duke e marrë parasysh edhe shtrirjen dhe mënyrën e menaxhimit të tij, duke filluar prej jo konkurshmërisë së plotë, kualitetit të dobët dhe tendencës së nepotizmit nëpër institucione të tilla dhe ndikimit politik që po i shkatërron këto universitete.

Ju kisha lutur që këtu të keni qartësim të pozicioneve në raport me ligjin që e përmendet për arsimin e lartë. Ne po e shohim që po përfundon pjesa e parë e këtij viti dhe akoma nuk ka arritur në Kuvend dhe kjo tregon se po ngecim në hapa të përgjegjësive. Ajo çka kam arritur me e lexuar në raport e kam pa se nuk keni arritur me i dhënë kahe të mbulimit të problematikave në Ministrinë e Arsimit dhe kjo besoj që do të na lejoj edhe neve ta rruajmë dozën jo vetëm të opozitarizmit, por ta ruajmë dozën që të jemi kritik deri në atë masë që ju mund të arrini prej këtij pozicioni që e keni si ministër.

Mendoj se keni nevojë ta funksionalizoni dhe fuqizoni zyrën ligjore, nga ajo që shihet dhe ju që keni treguar këtu, do të thotë se nëse ju flisni në vazhdimësi për nxjerrjen e një udhëzimi administrativ, atëherë është e pa imagjinueshme se çfarë kapacitete ligjore keni.

Pjesë tjera që ju i potencuat me nene dhe që lidhen me MSA-në, tash janë problematikë në vete dhe që lidhen me koston buxhetore, por ky është programi politik i kësaj Qeverie me një përgjegjësi të harxhimit të parasë publike, pa ditur me definuar në sektorët që janë të rëndësishëm dhe cili kthehet në zhvillim të vendit, sepse pa një arsim cilësor dhe efikas ne do të sillemi në rreth vicioz dhe nuk do të jemi konkurrent në atë çka kërkohet në tregun e hapur në raport me vendet e rajonit.

Në vazhdim ia parashtrij dy pyetje ministrit:

1. A ka më probleme për njohjen e nostrifikimit të diplomave qoftë edhe për qytetarët që jetojnë në Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc, pjesa që lidhet me marrëveshjet e Brukselit.

2. Çka keni bërë për diasporën në raport me ministrinë e Diasporës për shpërndarjen e materialeve dhe teksteve shkollore, sepse neve po na asimilohen qytetarët tanë atje për tekste shkollore në gjuhën amtare.

Ahmet Isufi tha se raportet që po vijjnë si nga brenda dhe nga jashtë që tregojnë një nivel të ultë të arsimit në Kosovë, është treguesi që ju keni me u atakuar me shumti në këtë drejtim, sepse në të kaluarën janë ndërthurur shkolla dhe objekte shtesë, kurse tani është cilësia në pyetje dhe kësaj tani duhet t'i jepni rëndësi duke i marrë modelet që kanë avancuar, sepse tani nuk është një sistem që ka ekzistuar standard si përpara, por çdo ditë ka lëvizje të zhvillimit të teknologjisë dhe proceseve.

Kisha dashtë të dija se a keni bashkëpunim me ministrinë e tjera dhe agjencitë e ndryshme që janë të interesuara edhe për shkollat profesionale që u përmenden, sepse ekzistojnë qendra profesionale dhe sa po i përgjigjen tregut të punës këto profesione që

dalin nga këto qendra, dhe për shkak të ndryshimit të rrethanave, ndoshta është e domosdoshme të ndryshohen edhe veprimtaritë ose ato që janë interesa profesionale në mënyrë që të rinjtë kur dalin menjëherë t'i përgjigjen tregut të punës.

Fatmire Kollçaku theksoi se është për keqardhje me filluar diskutimin me konstatimin nga Raporti i progresit se nuk ka pasur lëvizje pozitive në arsim, si ministër nuk mund ta merrni përgjegjësin për krejt këto dështime, por ju bie përgjegjësia për përmirësime aq sa mundeni.

U fol për rëndësinë e agjencisë të akreditimit dhe arsimin e lartë i cili ka shumë probleme sepse para ligjit janë të barabarta edhe institucionet publike dhe ato private.

Qëllimi është të ngritet cilësia nëpër universitetet private që pastaj të jenë konkurrent në treg të punës, ndërsa nuk e di se sa e keni kontrollin mbi këtë arsim sepse financohet vetë dhe është në një farë forme shumë i pavarur, ndoshta nuk bie në domenin e temës së sotme, por kemi njohur që aty është interesi të bëhet pagesa vit për vit nga studentët, ndërsa ata mund t'i bartin provimet nga viti i parë dhe të shkojnë dhe të bëhen absolventë duke i bartur provimet, e mandej nuk është interesi i fakultetit a diplomojnë apo jo, por qëllimi është që pagesa të kryhet, kështu që ata studentë kur nuk mund ta zënë hapin dhe të jenë të mirëfilltë kur të diplomojnë.

Këto janë deformime të mëdha që po ndodhin në institucionet private dhe do të ishte mirë të jetë një mbikëqyrje më e mirë.

Në vazhdim tha, me intereson integrimi gjinor, sepse te shkollat profesionale është interesimi shumë i vogël i vajzave, a janë të informuara ato në këtë drejtim.

Çështje tjetër është edhe cilësia e arsimit nëpër shkollat e mesme që nuk është përmendur shumë.

Kur nxënësit tanë po shkojnë jashtë shtetit, shumë më lehtë po kalojnë në shkolla fillore dhe të mesme, atëherë shtrohet pyetja, a po i mbingarkojmë në nxënësit me njohuri të tepërta që pastaj nuk po janë të suksesshëm?

Tani është provimi i maturës dhe ai pranues, sa është menduar që të korrigjohen këto, sepse provimi i maturës është i konceptuar, jo me e kalua nxënësin, por me e penguar në kalim, pra duhet me e gjetur mënyrën se si me i ndihmuar nxënësit që njohurit që i kanë fituar me qenë konform testit të provimit, sepse nuk po ndahet ajo çka është e duhur nga ajo që është e tepërt, është mbingarkesë për nxënësin, njëherë provimi i maturës e pastaj menjëherë provimi pranues në fakultet. Andaj a është duke u menduar në këtë drejtim që të mbetet vetëm njëra?

Sa i përket testit pranues krejt fokusimi, është bërë me ndaluar kopjimin, mirëpo ministria e ka obligim me shikuar pse është ky problem dhe pse është kaq nevojë e madhe e nxënësve me kopjuar, pra duhet me rishikuar çfarë janë testet dhe me i bërë konform planë- programeve.

Ky është gabimi dhe deformimi i sistemit të arsimit në Kosovë, sepse mbingarkohen me detaje nxënësit dhe nuk i mësojnë gjërat bazike.

Milaim Zeka theksoi se bazuar nga përvojat e tjerëve, e di se investimi me i madh duhet me u bërë që nga çerdhja dhe ju ministër duhet të merreni shumë seriozisht me këtë çështje. Unë edhe në seancë e kam thënë dhe po e ri përsërisë, se çdo shkollë në çdo fshat të Kosovës mund ta rezervojë nga një dhomë të veçantë për ta shndërruar në çerdhe.

Mendoj se faktori kryesor për ngecjen e shumë gjërave në Kosovë, nuk është buxheti, por faktori njeri. Sa i përket agjencisë që u cekën më parë, jam kategorikisht kundër tyre, sepse duhet të krijohen departamente në ministri, sepse agjencitë janë piramidat kryesore të korrupsionit dhe matrapazllëqeve. Kam fakte që këto agjenci janë

shndërruar në mini- shtete dhe janë opozita ma e rëndë e ministrive dhe gjithë këtë problem e kanë gatuar qeveritë e mëparshme dhe Parlamenti i Kosovës.

Në vazhdim pyeti, ju si ministri a keni kontroll mbi Universitetin e Prishtinës mbi dy gjëra, pasqyrë e një universiteti është oborri i tij, shko shikojeni se në çfarë gjendje të mjerueshme është dhe pastaj futuni nëpër korridore, ku do t' ju krijohet ndjenja se jeni në një stacion treni të viteve të më hershme, nuk ka libra nëpër korridore, nuk ka ndriçim të mjaftueshëm dhe krejt këta matrapazë që e kanë udhëhequr universitetin prej të parit deri te ky i tanishmi janë përgjegjës dhe duhet të përgjigjen edhe juridikisht.

E kam një listë të shpenzimeve marramendëse që janë bërë në universitet për dreka dhe darka zyrtare është 44.000 € andaj nëse ju ministër e merrni guximin qytetar me e publikuar para qytetarëve të gjitha keqpërdorimet që i kanë bërë ministrat në Ministrin e Arsimit, me i publikuar në ueb-faqen zyrtare të gjitha keqpërdorimet që janë bërë në Universitetin e Prishtinës, jo në ato private, atëherë do të dërgoni mesazh tek ata ministra që vijnë pas jush dhe kanë me thënë se ngadalë se vjen një ministër që na turpëron dhe na çon në prokurori. Prandaj ju inkurajoj si ministër i ri dhe nuk figuroni në listat e njerëzve keqpërdorues në të kaluarën që ta keni guximin që këto gjëra t'i bëni publike dhe t'i çoni reformat deri në fund.

Fitore Pacolli tha se deputeti Zeka përmendi shumen marramendëse të shpenzuara për dreka dhe darka, paramendoni nëse këto para të ishin investuar në libra dhe biblioteka, të cilat janë në gjendje të tmerrshme, andaj ministër mendoj se kjo duhet rregulluar dhe drekat dhe darkat duhet të reduktohen dhe buxheti duhet të shkojë në libra për studentët dhe biblioteka, jo vetëm në universitete, por edhe nëpër shkolla.

Kemi shkolla filllore që ende u mungojnë bibliotekat dhe këto objekte shkollore që i kemi janë në gjendje të tmerrshme, nuk kanë ndryshua asgjë, por përkundrazi janë përkeqësuar. Mungojnë pajisjet për gjimnastikë, ende po ndërtohen shkolla pa sallë të edukatës fizike, pa hapësira rekreative, pa hapësira të kuzhinës. Kur e kemi shqyrtua projektligjin për buxhetin e kam ngritur këtë çështje dhe nuk e di se a keni marrë parasysh. Ju lus që në çfarëdo projekti që është për ndërtimin e shkollave të ndërhyni dhe mos të lejoni që të ndërtohen shkollat pa salla te edukatës fizike dhe pa kuzhina.

Ne vazhdim tha se cili është qëndrimi juaj sa i përket përmirësimit të cilësisë nëpër shkolla dhe universitete, me sa e di buxheti është zvogëluar, andaj cili është plani juaj në të ardhmen sepse nëse e keni në plan me e rritur cilësinë pa buxhet nuk mundeni.

Gjithnjë jam e interesuar për edukimin parashkollor dhe fillor sepse nëse të kishim investuar prej përfundimit të luftës deri me sot në këto nivele do të kishim studentë të përgatitur, sepse ne kemi sot student të cilët nuk e dinë dallimin mes fjalës dhe fjalisë. Këtu nuk është faji i studentit, por i shkollës dhe kurrikulave të cilat kanë ardhur gjithnjë të ndryshme.

Në vazhdim pyeti, sa çerdhe private janë të licencuara në Kosovë që punojnë me kushte normale, sepse kemi çerdhe që punojnë pa kushte, sa herë i kontrolloni dhe i mbikëqyrni sepse janë kompetencë e ministrisë e jo komunave, në çfarë kushte punojnë dhe sa çerdhe i keni mbyll për shkak se si kanë plotësuar kriteret.

Në fund tha se nuk e kuptova, të na shpjegoni projektin për 0 deri në 2 vjeç dhe 3 deri në 5, çka po mendoni me bërë?

Fikrim Damka tha se kemi pasur kërkesa që të kemi arsim më cilësor për gjuhen turke dhe boshnjake, ai tha se haptas mund të them se arsimi në gjuhen turke dhe boshnjake janë mbrapa për 1 vit prej arsimit në gjuhen shqipe edhe nga agjenda, nga arsimi, kurrikulave dhe trajnimeve. Në shkollat filllore nuk janë të kompletuara librat në gjuhen

turke, mungojnë 7 ose 8 libra, kurse në shkollat e mesme nuk kemi asnjë libër që mësojnë, pastaj nëpër teste të maturës nxënësit po ngelin. Kemi mungesa të trajnimeve të arsimtarëve me kurrikula të reja.

Pastaj tha se mungojnë inspektorët që kontrollojnë, sepse nuk mundet një inspektor që nuk e njih gjuhen turke dhe boshnjake t' i vlerësojë arsimtarët se si e mbajnë mësimin nëpër klasa. Kemi pasur kërkesë që të kemi 1 ose 2 inspektorë që mund t'i kontrollojë arsimtarët në gjuhen turke dhe boshnjake, pastaj kemi pasur edhe kërkesa për zyre për arsim në gjuhen turke dhe boshnjake sepse pa këto zyre nuk mund të kemi kontrollim të mirëfilltë për këto çështje, e kemi një zyre për komunitete në kuadër të Ministrisë së Arsimit, por nuk mjafton sepse është vetëm një zyrtar.

Duhet të krijohet një zyre me 3 ose 4 ekspertë të fushave dhe të ketë një kontroll dhe do të jetë ndihmesë edhe për vetë ministrin!

Ne duhet ta formojmë piramidën institucionale ashtu që të munden të zgjidhen këto çështje.

Ministri theksoj se lidhur me atë që është thënë në Raportin e progresit se gjendja në arsim nuk ka lëvizur, ka stagnuar, konsideroj se kjo nuk është risi as për mua si ministër dhe për askënd, sepse që në ditën e parë kur e kam marrë detyrën si ministër e kam thënë se gjendja në arsim nuk është e mirë, por duhet të marrim hapa konkret se si të dalim nga kjo gjendje.

Do të isha edhe unë i lumtur që gjërat të rregullohen për 6 muaj apo 1 vit, por të jemi real se nuk mund të rregullohen për një periudhë të shkurtër dhe as për një mandat 4 vjeçar.

Problemi në arsim ka një afat të gjatë që është shkaktuar dhe ajo çka e konsideroj që është një hap pozitiv, është se po flitet për arsimin e nivelit të përgjithshëm dhe për ta marrë një hap të mbarë arsimi duhet një angazhim i përgjithshëm, duhet një vullnet shoqëror dhe politik për të dalë nga situata. Esenca është se shumë përgjegjësi nuk janë vetëm të ministrit, por i takojnë edhe nivelit lokal, pushteti lokal e ka një përgjegjësi të madhe mbi cilësinë e arsimit, ne kërkojmë që së bashku me pushtetin lokal t' i dakordojmë veprimet në mënyrë që t' i gjejmë zgjidhjet për problemet që janë akumuluar me vite, një vullnet e kemi pozitiv që një nga një problemet t' i shtrojmë dhe t' i zgjidhim problemet në arsim në të gjitha nivelet.

Në vazhdim lidhur me problemin e themelimit të agjencisë për profesionet e rregulluara, tha se kjo çështje nuk do të shkojë në pafundësi, por do të rregullohet brenda këtij viti, ose do të themelohet agjencia, ose do ta formohet një departament shtesë që do të merret me çështjen e profesioneve të rregulluara dhe mund të jetë çështje që mund ta rregullojmë brenda ministrisë, Kurse lidhur me pyetjen që u shtrua, për mos hartimin e udhëzimeve administrative nga zyra ligjore, kjo nuk është bërë për mungesë të punës, por pikërisht sepse ende nuk është krijuar agjencia dhe nuk është krijuar baza e akteve nënligjore, sepse nuk është funksional agjencia. Qasje tjetër lidhur me problemet është se kemi probleme me PKZMSA, sepse shumica e projekteve të përcaktuara janë në të dhe problemi kyç vazhdon të jetë buxheti, për me i realizuar brenda vitit të gjitha objektivat na duhen 18 mil. buxhet, kurse ne i kemi mangët 11 mil.€ që është një diferencë e madhe dhe 7 milionë po mbulohen nga partnerët ndërkombëtarë që po na financojnë me donacione ,nëse duam të ndryshojmë diçka duhet ti japim rendësi buxhetit sepse nuk mund t' i zgjidhim gjërat pa buxhet. Ne do t' i paraqesim kërkesat tona me rishikim të buxhetit.

Lidhur me pyetjen nëse themi se për moshat 0 deri 2 vjet nuk është zgjidhje edukimi në shtëpi, por në çerdhe, në teori po, por në praktikë është e pa mundur me u realizuar, sepse ne nuk po mund ta realizojmë si duhet vijueshmërinë për 3 deri në 5, kjo për

shumë arsye, edhe për mungesë të infrastrukturës, për mungesë të edukatoreve por edhe për mungesë të kostos që mund ti ngarkojmë këto familje, pra janë shumë faktorë, por nuk duhet të harrojmë se për moshat 0 deri 2 vjet duhet t'i bëjmë prindërit të gatshëm t'i çojnë fëmijët në çerdhe, sot lehtë është të flitet për vendet urbane, por shqetësimin e kemi te vendet jo urbane.

Lidhur me shkollat jemi në bashkëpunim me Bankën botërore që në ato shkolla ku ka mundësi të adaptohen që të jenë çerdhe, ne do të tentojmë t'i shndërrojmë, por nuk është e lehtë që me e shndërruar një pjesë të aneksit të shkollës në çerdhe. Ministria në bashkëpunim do t'i identifikojë të gjitha shkollat që kanë tepricë të ambienteve dhe pastaj ta shohim mundësinë që të ndërtojmë institucione parashkollore jo vetëm me një dhomë ku do të futen fëmijët, por duhet të plotësohen të gjitha kushtet duke filluar nga kuzhina për ushqim dhe të gjitha pjesët e tjera të duhura.

Lidhur me kurrikulat tha se secili institucion shkollor do të ketë për obligim t'i respektojë kurrikulat që do të jenë zyrtare nga ministria dhe i mbetet mekanizmit të inspektoratit të i kontrollojë secili institucion se sa po respektohen kurrikulat në të gjitha nivelet.

Jemi në fazën finale të hartimit të koncept dokumentit për projektligjin për parashkollor.

Te fëmijët me nevoja të veçanta ka qenë shqetësuese pse nuk është ndarë një linjë buxhetore e veçantë, por atë çka kemi bërë ne aktualisht është se në grandet se më specifike për komuna ta fusim pjesën buxhetore shtesë për asistencë të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe në mbledhjen e fundit të Këshillit ekonomik social kemi kërkuar dhe është miratuar një kod i veçantë për të punësuarit si asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta.

Lidhur me pyetjen se a do të ketë largime nga puna, ministri tha se nuk do të ketë kur largime nga puna në asnjë institucion që i raporton Ministrisë së Arsimit për çfarëdo arsye, nëse nuk e ka arsyen kryesore që nuk i kryen përgjegjësinë kryesore për të cilën e ka marrë. Brenda agjencisë së akreditimit fatkeqësisht ka pasur lëvizje, janë larguar disa vullnetarisht, por nuk i di arsyet pse janë larguar, por asnjë individ nuk është larguar dhe nuk do të largohet për arsye të tjera, përveç nëse nuk i kryen përgjegjësit që i ka.

Tek autoriteti kombëtar i kualifikimeve për neve ka qenë shqetësuese, nuk i kemi pasur informacionet e duhura dhe kemi arritur ndoshta me vështirësi tek informacionet e duhura dhe tani jemi në rrugë të mbarë, kemi bërë disa takime me udhëheqësit e agjencisë dhe kemi ftuar të gjitha shkollat profesionale dhe jemi dakorduar që ta bëjmë një strategji të përbashkët që shumë shpejt të akreditohen programet e këtyre shkollave në mënyrë që deri ne fundin e vitit ne të jemi të gatshëm për raportim në Këshillin Evropian të kualifikimeve, por ajo çka kemi informata, ka shumë profile që janë të gatshëm për të aplikuar dhe me aplikimin e gjithë këtyre nuk do të rrezikohemi për t'u larguar nga kjo agjenci dhe deri ne korrikun e vitit 2019 duhet të mbyllet akreditimi i të gjitha këtyre institucioneve publike. Është një gatishmëri e përbashkët që me ju qas problemeve dhe me i zgjidhur ato.

Këshilli shtetëror i cilësisë është aktiv dhe me përkrahjen tonë dhe të shoqërisë civile dhe kushdo që shpreh gatishmërinë me na ndihmuar do të marrim një vendim të drejtë.

Armend Zemaj e pyeti ministrin, a do të jeni kështu të hapur edhe për vlerësimin e kritereve për akreditim.

Ministri tha se jo vetëm që do të jemi të hapur, por kemi kërkuar edhe publikisht që të ulemi dhe t'i rishqyrtojmë edhe politikat e akreditimit dhe ri akreditimit të programeve,

një problem të rëndë e kemi pyetje kohën, sepse këtë vit ka shumë programe dhe shumë institucione që duhet të ri cilësohen dhe jemi vonë me kohën për shkak të problemeve që janë shkaktua deri me funksionalizimin e agjencisë, ndoshta duhet ta marrim një vendim kalimtar deri në krijimin e kushteve që t'i futemi rishikimit të mirëfilltë të akreditimit të programeve.

Sa për informim unë i kam ngritur dy tema që presin në nivel të Qeverisë dhe aktorëve të tjerë që në po mbajmë takim të rregullt që t'i qasemi edhe arsimit të lartë që të diskutohen dy tema të nxehta, e para, regjistrimi i studentëve nëpër institucionet e arsimit të lartë për profesionet që ne i kemi mangët dhe profesionet që nuk na duhen për 10 vitet e ardhshme.

Sa i përket nepotizmit në arsimin e lartë, ka ekzistuar dhe po ekziston, kjo është edhe arsyeja që i kemi bërë Universitetit të Prishtinës, që të respektohen procedurat dhe kemi bërë thirrje që trurit kosovar, të rinjve tanë që kanë kryer doktorata dhe mastera në institucionet e larta të njohura evropiane, tu jepet mundësia në konkurrim dhe të merrem parasysht.

Kriteret duhet t'i ketë parasysht edhe senati dhe komisioni që banë vlerësimin dhe nuk mund të jetë i barabartë me atë ai që vjen me një përgatitje dhe publikime të nivelit krejt me të lartë.

Milaim Zeka u ndërlihdh ne diskutim dhe tha se ne e dimë se në Universitetin publik të Prishtinës edhe shoqatat studentore janë të formuara prej partive të ndryshme politike, andaj ju sugjeroj të mos i lexoni portalet, mos i dëgjoni çka thonë për juve dhe mos e këqyrë atë staf akademik sepse gjysma janë analfabetë, por problemi është që t'i çoni përpara gjërat me vendosmëri pa menduar të votat.

Ministri tha se brenge kyçe e kam se a jam duke e respektuar legjislacionin në fuqi dhe mos po bëj ndonjë shkelje dhe a jemi duke bërë politika të mira që këto probleme që ekzistojnë në sistemin e arsimit të shkojnë në drejtim të duhur.

Në vazhdim tha, te nostrifikimi i diplomave, edhe këtu e kemi një situatë jo të mirë, ka pasur pritje të qytetarëve tanë për një nostrifikim me vite të tëra. Në nëntor të vitit të kaluar e kemi pasur një auditim të brendshëm, i kemi identifikua problemet e vonesave kaq të mëdha dhe sot jemi në një situatë që askush nuk do t' i presë për nostrifikim me tepër se 60 ditë.

Te diaspora kemi finalizuar kurrikulat bashkë me Shqipërinë, ndërsa Ministria e Arsimit çdo vit ju dërgon libra në diasporë sipas kërkesave që na vijnë. Tani jermi në fazën e një qasje të përbashkët me Shqipërinë, qoftë të financimit të mësimdhënësve dhe trajnimit të tyre në diasporë dhe javën e ardhshme do të kemi takim me ministrin e Arsimit të Shqipërisë për t'i konkretizuar gjërat për qasjen me diasporën.

Lidhur me komunitetet i kam dy zëvendësministra dhe një këshilltar për komunitete, e kanë për detyrë t'i identifikojnë të gjitha problemet për komunitete.

Te librat shkollorë në të cilën kanë ekzistuar fjalorë jo të mirë dhe probleme teknike, kemi marr masa, i kemi përmirësuar gabimet, kemi kërkuar nga shtëpitë botuese që me material shtesë të shkohet në përmirësim të gabimeve.

Javën e kaluar kemi bërë publikimin e thirrjes publike për librat e reja që do të përpilohen nga autorët dhe shtëpitë botuese dhe priten që të jenë të finalizuara në vitin 2019-2020 që do të jenë në përputhshmëri të plotë me kurrikulat që i kemi në fuqi. Ajo çka kemi bërë me udhëzimin administrativ është çështja e recensentëve që do ta kenë rolin kyç dhe përgjegjësin penale nëse librat që lëshohen në përdorim nuk i plotësojnë kriteret profesionale dhe gabime.

Te pyetja se a duhet me qenë edhe provimi maturës dhe provimi pranues tha, ne aktualisht me ligjet e zbatueshme në fuqi parashihet të kemi test të maturës, kurse provimi pranues është politik e universiteteve dhe në mënyrë të pa varur i krijojnë këto politika dhe ne nuk mund të ndërhyjmë. Për herë të parë ne kemi bërë që testi i maturës mos të mbahet në një ditë, por e kemi ndarë në 4 rajone dhe do të mbahen 4 ditë dhe qëllimi është që testi të mbahet mirë.

Nuk është problemi i testit, por i modelit të arsimit dhe sëbashku me nivelin lokal të gjejmë zgjidhje sepse kurrikulat e reja nuk parashohin këtë se çka po ndodh nëpër shkolla, kemi një projekt të trajnerëve nacionalë dhe konsideroj se me këtë projekt do të fillojmë një fazë krejt të re të qasjes së trajnimeve të nxënësve.

Kurse lidhur me pyetjen e arsimit profesional tha është prioritet i yni dhe jemi duke vijuar strategjinë e shkollave profesionale sepse me krijimin e strategjisë se mirëfilltë ne do të ndikojmë në mënyrë indirekte edhe te çështja e cilësisë te arsimit i lartë.

Kurse lidhur me pyetjen e rregullimit të oborrit të universitetit tha, se është cenim i pavarësisë ekonomike nëse u themi se nuk po e mbajnë mirë, por menaxhmenti e ka obligim të merret me këto çështje, por ne vetëm mund të bëjmë presion pozitiv për mes këshillit drejtues që të kenë kujdes për këtë dhe çështje të tjera.

Kurse në fund lidhur me çerdhet tha se e kemi një projekt për ndërtimin e tyre me ndihmën e projektit IPA dhe projekti tjetër që e diskutuam në shkollat ku ka mundësi të adaptohen si duhet ne do t'i shndërrojmë në çerdhe, dhe ky është synimi ynë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Lidhur me këtë projektligj kryetarja tha se kemi pranuar disa propozime nga Zyra e BE-së për nenin 2 .1 dhe nenin 12, propozoj që ta shtyjmë për mbledhjen tjetër.

Armend Zemaj tha se ne nuk kemi nevojë ta shtyjmë për mbledhjen e radhës sepse është kompetencë e Komisionit Funkcional, për ne është që të konstatojmë se a janë në përputhje me legjislacionin e BE-së këto vërejtje, ashtu siç janë për ne të vonuara, janë të vonuara edhe për Komisionin për legjislacion, propozoj që projektligjin t'ia kthejmë Komisionit Funkcional që ata t'i harmonizojnë qëndrimet dhe pastaj ta sjellin te ne.

Kryetarja e hodhi në votim propozimin e deputetit Zemaj dhe konstatoj se Komisioni me shumicë votash nxori këtë;

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, me amendamentet e Komisionit Funkcional t'i kthehet Komisionit për Legjislacion në mënyrë që të harmonizohen qëndrimet dhe pastaj të kthehet në komision për shqyrtim.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Lidhur me këtë projektligj **Kryetarja** paraqiti opinionin ligjor, tha se ky Projektligj sëbashku me amendamentet e Komisionit Funkcional është në përputhje me dispozitat e

legjislacionit të BE-së. **Kryetarja** hodhi ne votim Projektligjin dhe konstatoj se Komisioni një zëri nxori këtë;

Rekomandim

Projektligjit nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të procedohet për miratim në Kuvend.

6. Të ndryshme

Në këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi ne orën 12:50.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetare e komisionit,

Blerta Deliu- Kodra
